



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:267181

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05744428

K.DH.SH.II.nr.726/24

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhtija Ymeri, kryetare e kolegjit, Dren Rogova dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Star Trade” Shpk me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCRL Partners”-Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, KF.nr.691/23 të datës 26.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.05.2024, merr këtë:

### **A K T V E N D I M**

APROVOHET si e bazuar ankesa e paditësit “Star Trade” Sh.p.k me seli në Prishtinë, aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, KF.nr.691/23 të datës 26.01.2024, prishet dhe lënda i kthehet Dhomës së Shkallës së Parë në rigjykim dhe rivendosje.

## A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e ankimuar, nën pikën I. të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, “Star Trade” Shpk me seli në Prishtinë, nën pikën II. në fuqi Aktvendimi i Doganave të Kosovës nr.07.3/1174/2015 i datës 16.04.2019. ndërsa nën pikën III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ushtron paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me të cilin e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të dispozitave materiale dhe shkeljeve të dispozitave procedurale. Duke propozuar që Dhomat e Shkallës së Dytë pranë Gjykatës Komerciale të merr aktgjykim-të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e paditësit e parashtruar ndaj aktgjykimit të gjykatës Komerciale Prishtinë Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal KF.nr.691/23, Anulohet si i pa bazuar në tërësi aktgjykimi i Gjykatës Komerciale Prishtinë Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal KF.nr.691/23 sipas të cilit aktgjykim është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe është lënë në fuqi aktvendimi i të paditurës 07.3/1174/2015 i datës 16.04.2019.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitë e paditura.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222 dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Aktvendimin e organit të paditur nr.07.3/1174/2015 të datës 16.04.2019 është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedurë “Star Trade” Shpk-Prishtinë, për rishqyrtimin e vendimit nr.R-27549/29.10.2015 të ZBD Prizren.

I pakënaqur me aktvendimin e DK subjekti-paditësi, ushtron padi në procedurë të konfliktit administrativ në gjykatë në Departamentin Fiskal. Dhoma e Shkallës së Parë në këtë çështje, mbanë seancë të shqyrtimit kryesor si në vështrim të nenit 41 të LKA, në praninë e përfaqësueses së autorizuar të palës paditëse, e në mungesë të përfaqësuesit ligjor të palës së paditur, dhe pas administrimit të provave dhe vërtetimit të gjendjes faktike, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, ndërsa e lenë në fuqi aktvendimin e organit të paditur, nr.07.3/1174/2015 i datës 16.04.2019 sipas konkludimeve në arsyetim se: Gjykata konstaton se Dhomave të Shkallës së Dytë të kësaj gjykate me aktvendimin K.DH.SH.II.nr.948/22 të datës 12.07.2023, lëndën e kanë kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje pranë kësaj gjykate me arsyetimin se duhet mënjanuar shkeljet esenciale të dispozitave kontestimore nga neni 182 par.2 të LPK-së që janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktgjykimit të goditur. Në ri procedurë Dhoma e Shkallës së Parë duhet të shqyrtoj të gjitha vërejtje e dhëna nga kolegji i shkallës së dytë, duhet të bëjë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të Doganës së Kosovës ti eliminoj shkeljet e theksuara , të vendos në kuptim të nenit 160 të LPK-së, ashtu që dispozitivi dhe arsyetimi i vendimit të jetë i qartë dhe i kuptueshëm duke vlerësuar të gjitha provat veç e veç dhe të gjitha së bashku. Gjykata vlerëson se provat e tilla me të cilat është rivlerësuar malli lëndor është provë e bazuar për tu vlerësuar malli lëndor sipas nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht të dhënave të disponueshme, prandaj gjykata konstaton se është aplikuar drejtë dispozita ligjore kur është rivlerësuar malli lëndor. Nga arsyetimi vendimit kontestues e paditura ka dhënë konstatimin se paditësi nuk ka ofruar asnjë dokument që e përcakton vlerën e shpenzimeve të transportit, si faturën e transportit, transferin bankar që përcakton vlerën e shpenzimeve të transportit dhe as kontratën me transportuesin. Gjykata nga administrimi i provave konstatoi se dokumentacioni që ka paraqitur paditësi për të dëshmuar shpenzimet e transportit gjykata nuk i konsideroi si prova të mjaftueshme që dëshmojnë se paditësi ka paguar këto shpenzime transportuesit Pro Transport Shpk-Prishtinë. Paditësi nuk ka paraqit gjykatës asnjë dëshmi se si janë paguar shpenzimet e transportit, dhe cilat janë ato transaksione bankare. Prandaj gjykata ka pranuar konstatimet e të paditurës se paditësi nuk ka paraqit dokumentacionin e nevojshëm për tu pranuar pariteti i mallit lëndor si: pagesa, kontrata të cilat parashihen me dispozitën e nenit 2 të Udhëzimit Administrativ nr.04/2014 për Përcaktimin e Kostos së Shpenzimeve të Transportit të Mallrave të Importuara, që parasheh: Elementet që duhet të merren parasysh gjatë shqyrtimit të një Deklarate Unike Doganore lidhur me paritetin janë si në vijim 3.1.

çmimi i mallit për njësi; 3.2. natyra dhe specifikat e mallit; 3.3. origjina e mallit; 3.4, dokumentet e bashkangjitura. Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se paditësi as në këtë konflikt administrativ nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t'ia dëshmoj provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlerë e vërtet e transaksionit të paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç parashihet në dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109. Gjykata konstaton se e paditura në rastin konkret ka vepruar në mënyrë të drejtë kur ka rivlerësuar mallin e importuar nga paditësi duke dhënë arsyetim të mjaftueshëm se përse vlerësimi i mallit/ shpenzimeve të transportit nuk mund të bëhet me metodën e parë, siç parashihet me ligj, pasi që paditësi rezultoi të këtë dorëzuar dokumentacion jo të harmonizuar e të kërkuar ligjërisht dhe kështu ka dështuar të provoj edhe vlerën e transaksionit për mallin e kontestuar, si dhe çmimin e vërtetë të paguar, siç përcaktohet me nenin 33 par.1 të KDAK-së. Andaj nga një gjendje e tillë gjykata vlerëson se vendimi nr.07.3/1174/2015 i datës 16.04.2019 i të paditurës Dogana e Kosovës-Departamenti i Ankesave është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji i kësaj gjykate, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe pas shqyrtimit të aktgjykimit të ankimuar, dhe shkresave të tjera të lëndës secilën veç e veç si dhe në lidhshmerin e tyre, e duke i pasur parasysh edhe pretendimet ankimore të paditësit, gjen se aktgjykimi i ankimuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij, si dhe është jo i plotë lidhur në vërtetimin e gjendjes faktike, ashtu sipas nenit 182 par.2 pika (n) lidhur me nenin 183 të LPK-së.

Kolegji nuk mund ti përkrah si të rregullt dhe të ligjshme tani për tani qëndrimet juridike të gjykatës së shkallës së parë, pasi që arsyet në të cilat bazohet për faktet vendimtare lidhur me mënyrën e vendosjes janë jo të qëndrueshme dhe në kundërshtim me faktet të cilat i thekson paditësi në ankesë. Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se nga provat e lëndës, rezultoi se e paditura e ka rivlerësuar mallin doganor me rastin e zhdoganimit, dhe nuk ka pranuar vlerën e shpenzimeve të transportit. Edhe përkundër vërejtjeve të dhëna nga gjykata e shkallës së dytë me aktvendimin KDHSII.nr.948/22 dt.12.07.2023, se paditësi ka paraqit transaksionin bankar dt.03.11.2015 si dëshmi për blerjen e mallit doganor, gjykata e shkallës së parë në rigjykim, nuk ka dhënë vlerësim lidhur me transaksionin në fjalë, e po ashtu nuk ka marrë fare parasysh vërejtje e shkallës së dytë, por në mënyrë të përgjithshme

ka nxjerr konstatimin se paditësi nuk ka argumentuar me prova një gjende tjetër faktike nga e paditura.

Andaj, për arsyet e lartcekura, aktgjykimi i ankimuar priset dhe lënda i kthehet Dhomës së Shkallës së Parë në rigjykim. Ashtu që në ri procedurë, Dhoma e Shkallës së Parë, për ta vërtetuar drejt gjendjen faktike, të shqyrtoj edhe njëherë dokumentacionin e lëndës, sa i përket vlerës së mallit doganor dhe shpenzimeve të transportit, ashtu që sipas nevojës gjykata e shkallës së parë, mund të nxjerr ekspertizën financiare për ta vërtetuar drejt gjendjen faktike në kuptim të lartësisë së vlerës së mallit, harmonizimit të vlerës së dokumentacionit të mallit, dhe vërtetimin se a janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 33 i KDA-së. Gjithashtu gjykata e shkallës së parë të vlerësoj edhe pretendimet sa i përket kontestit të shpenzimeve të transportit për mallin doganor.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 195 par 1 pika (c) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë**

K.DH.SH.II.nr.726/24, me datë 28.05.2024

Kryetare e kolegjit,

Franciska Zhitija Ymeri